

5.	Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Vitisë	Drejtoria e Urbanizimit	Komunës	10.10.2021	KPF	22.10.2021	29.10.2021	
6.	Informata mbi implementimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Vitisë	Drejtoria e Urbanizimit	Kryetari i Komunës	10.10.2021	KPF	22.10.2021	29.10.2021	
7.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.10.2021	KPF	22.10.2021	29.10.2021	

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021**  
**NËNTOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËR GJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi procesin e legalizimit të objekteve	Drejtoria e Urbanizimit	Kryetari i Komunës	10.11.2021	KPF 22.11.2021	30.11.2021	
2.	Informate e Drejtorisë së Bujqësisë mbi të mbjellat vjeshore	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	10.11.2021	KPF 22.11.2021	30.11.2021	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.11.2021	KPF 22.11.2021	30.11.2021	

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021**  
**DHJETOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËR GJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi realizimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020 dhe informata mbi punën e Komiteteve obligative	Sekretaria e Kuvendit	Kryetari i Komunës	10.12.2021	KPF 22.12.2021	29.12.2021	Afati kohor

2.	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSRS-së	KKS	Kryetari i Komunës	10.12.2021	KPF 22.12.2021	29.12.2021
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.12.2021	KPF 22.12.2021	29.12.2021



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

16.07.2020

Organizimi	Numri/Broj	Emri/Emri	Vlera
Proj		Filog	Vrednes*
	05-016/01		625



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

### Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2019/20

Në Komunën e Vitisë procesi mësimor zhvillohet që nga: çerdhet, parashkollorët, mësimi i ulët i mesëm dhe ai i lartë mesëm dhe ai i mesëm profesional. Komuna e Vitisë ka gjithsej: 2 Çerdhe, një publike dhe një private, 17- Shkolla fillore të mesme të ulëta me 18 paralele të ndara si dhe 3-Shkolla të mesme të larta.

Viti shkollor 2019/2020 në tërë komunën e Vitisë ka filluar në të njëjtën datë në të gjitha shkollat d.m.th më 2 shtator 2019. Gjysmë-vjetori i parë apo periudha e parë ka përfunduar më 27 dhjetor 2019. Periudha e dytë që ishte në përfundim e sipër dhe periudha e tretë e vitit shkollorë gjegjësisht gjysmë vjetori i dytë nuk është arritur të përfundojë në infrastrukturë shkollore për shkak të pandemisë, pra para kësaj periudhe deri më 11 mars 2020, mësimi është zhvilluar normalisht.

Mësimi deri më 11 mars 2020 është mbajtur pra, i rregullt në objektet shkollore dhe pas vendimit të MASHT-it me rekomandim të IKSHPK-së është ndërprerë për arsye të parandalimit të përhapjes së pandemisë dhe siguri për nxënës. Me vendim të MASHT-it mësimi në distancë ka filluar më 23 mars 2020.

Duke filluar nga Çerdhet këto janë të dhënat e të regjistruarve, pra Çerdhja „Gëzimi Ynë” me gjithsej 100 fëmijë të regjistruar për këtë vit shkollor 2019/20. Çerdhja private „Hello Vitia” me gjithsej 73 fëmijë të regjistruar për këtë vit shkollor 2019/20.

SHFMU-të: 17 Shkolla fillore te mesme të ulëta me 18 paralele të ndara, me gjithsej 6236 nxënës të regjistruar në vitin shkollor 2019/20.

SHML: 3-Shkolla të mesme të larta -Gjimnazi „Kuvendi i Lezhës” , Shkolla Profesionale „Jonuz Zejnullahu” si dhe Shkolla mikse „Kongresi i Manastirit” Pozheran, me gjithsej 1641 nxënës të regjistruar në vitin shkollor 2019/20.

Përfundimi gjysmë-vjetorit të dytë, periudhës së tretë të vitit shkollor 2019/20 në 17- SHFMU dhe 18-SHFMU paralele të ndara si dhe në 3- SHML ka përfunduar në bazë të kalendarit shkollor 2019/20 të nxjerrë nga Udhëzimi Administrativ MASHT-it. Pra sipas këtij kalendarit:

Klasa e 12-Maturantët këtë vit shkollor kanë përfunduar me mësim me 20.05.2020

Klasat 9; 10; 11 kanë përfunduar mësimin më 11.06.2020

Ndërsa para-fillorët dhe klasat 1-8 kanë përfunduar mësimin më 26.06.2020.

DKA ka organizuar dhe menaxhuar mësimin në distancë në bashkëpunim me drejtorët e shkollave si dhe ka organizuar trajnime mbi përdorimin e drejtë të platformave për shfrytëzim sa më të mirë nga ana e mësimitdhënësve të drejtuara nga mësimitdhënës të lëmisë së informatikës . Të gjitha shkollat e komunës së Vitisë duke përfshirë pothuajse të gjithë nxënësit rreth 93% e nxënësve janë përfshirë në mësimin online siç edhe janë dorëzuar raportet nga shkollat, por për fat të keq kemi një përqindje të nxënësve për të cilët ka qenë i pamundur të mësuarit online përveç në RTK- për ata të SHFMU-ve, për shkollat e mesme nuk ka pasur edicione mësimore në TV RTK që e ka bërë edhe më të vështirë të nxënësve. Këta nxënës nuk janë kyçur kryesisht në mungesë të teknologjisë dhe varfërisë së skajshme edhe pse aty këtu më disa donacione jemi munduar ta zbusim këtë gjendje.

Viti shkollor 2019/20 apo gjysmë-vjetori i dytë, periudha e tretë është përfunduar në të gjitha shkollat me data të parapara nga MASHT-i për këtë vit shkollor, të gjithë nxënësit janë notuar, raportet e mësimitdhënësve janë dorëzuar në shkollat ku punojnë si dhe të gjitha punët teknike – administrative janë kryer duke ju përmbajtur udhëzimeve administrative të kërkuara nga MASHT-i për organizimin e mësimit online apo në distancë,për përfundimin e vitit shkollor 2019/20. Sa ka qenë i suksesshëm apo me ngecje, jemi të vetëdijshëm që ndoshta nuk janë arritur objektivat 100% por afër 90% të tre mujorit të fundit janë arritur gjithsesi. Të gjitha raportet e dorëzuara në DKA janë përcjellë në MASHT ku edhe ka dalë raporti i vlerësimit përfundimtar i mësimit në distancë, pra në mënyrë përmbledhëse për tërë Kosovën.

**Vërejtje:** Dy testet, testi i arritshmërisë klasa e nëntë si dhe testi i maturës klasa e dymbëdhjetë që organizohet për çdo fundvit shkollor me vendim të MASHT-it janë shtyrë për datat 20.08.2020 testi i arritshmërisë si dhe më 29.08.2020 testi i maturës.



Më: 14.07.2020

Basri Aliu

Drejtor i DKA-së

Viti



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Komuna e Vitisë**  
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primaljeno Më/Dana		14.02.2020		vit/gor
Nr./organi Org.broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Wednos*	
	02-052/01-613			

ZYRA E PROKURIMIT

## RAPORTI PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA PËR GJASHTËMUJORIN 2020

(JANAR-QERSHOR 2020)

QERSHOR 2020

Raport ka të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotsimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenjes qytetare në përgjithësi, keto aktivitete zyra i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e prokurimit ka përgaditur këtë Raport për aktivitetet e prokurimit 6 muhor për vitin 2020, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në këtë gjashtëmuhor

Në gjashtë muhorin e vitit 2020, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese zyra ka inicuar 40 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna; 9 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime, 16 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe 15 me lëndë prokurimi Furnizime. Nga këto aktivitete, 24 janë përmbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 24 raste është përdorë procedura e hapur, 8 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 2 aktivitete procedurë me Vlera minimale, dhe 5 aktivitete procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 24 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; 16 aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm.

Nga 84 aktivitete të prokurimit të parapara për vitin 2020, në këtë 6 muhor janë realizuar 48 % e aktiviteteve të gjithmbarshme të planifikuara

Zyra e prokurimit përveq këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për Operatorët Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 1,018,028.89 €.

Zyra e prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **566 Urdhërblere** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë gjegjësishte ekzekutim. Zyra e prokurimit ka kryer edhe 80 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlersim dhe komisioneve tjera.

Gjithashtu duhet potencuar se Zyra e prokurimit në gjashtë mujorin e parë, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Menaxher i zyrës së prokurimit



Fadil ABAZI ,